



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:027624

Datë: 26.03.2024

Numri i dokumentit: 05507891

**P.nr.230/21**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal**, gjyqtari i vetëm gjykues Arlind Sharani, me zyrтарin ligjor Amar Hoxha, në çështjen penale kundër të akuzuarit M.Ç., nga Prizreni, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par.8 lidhur me par. 6 dhe 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP/II.nr.203-9/2021, të datës 24.02.2021, pas mbajtjes së seancës publike për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë me datën 26.03.2024, në prezencën e prokurores së shtetit Ramadan Koro, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij av. A.A., nga Prizreni, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli ndërsa me datën 26.03.2024 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari:**

**M.Ç.**, nga i ati ....., e ëma ....., e gjinisë ....., i lindur me datën .....në Tetovë, R. e Maqedonisë së Veriut, tani me vendbanim në Prizren, ku edhe tani banon në rr. “.....” p.nr., i martuar – i ati i katër fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, teknik mjekësor, i gjendjes së dobët ekonomike, goran, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal: .....

**Ë S H T Ë F A J T O R**

Se me datën 03.01.2021, rreth orës 08:20, në Prizren, në rrugën “Shtutgarti”, në vendin e quajtur “Transiti i vjetër” saktësisht në afërsi të pompës së derivateve “.....Petrol”, i pandehuri derisa drejtonte automjetin e markës dhe tipit “.....”, me targa të regjistrimit ....., ngjyrë e kaltër, vepron në kundërshtim me nenin 53 dhe 59 të Ligjit mbi rregullat e trafikut rrugor dhe nga pakujdesia, ka rrezikuar pjesëmarrësit në komunikacion dhe ka vënë në rrezik jetën e njerëzve, në atë mënyrë që kur arrin në vendin incidentit, nuk ia përshtat shpejtësinë e lëvizjes, kushteve dhe rrethanave në rrugë, kur hynë në kthesë, në të majtë në drejtimin e tij të lëvizjes pasi që rruga ishte e rëshqitshme nga të reshurat e shiut, ku si pasojë e kësaj automjeti fillon të rrëshqet duke dal jashtë rrugës në anën e majtë të tij të lëvizjes, me ç’ rast përveç dëmeve materiale në automjet, lëndime të rënda trupore pëson bashkudhëtarja-e dëmtuara M.Ç., lëndime të lehta trupore pësojnë bashkudhëtarët-të dëmtuarit: S.Ç., A.Ç., dhe Sh.J., lëndime këto të konstatuara në mendimin e ekspertit mjeko-ligjor dr. N.U., të datës 06.02.2021.

**Me këto veprime ka kryer veprën penale: rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par.8 lidhur me par. 6 dhe 1 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 8, 9, 10, 17 par.1, 38, 39, 40, 42, 43, 44, 69, 70 dhe nenit 370 par.8 lidhur me par. 6 dhe 1 të KPRK-së, si dhe nenit 364 të KPP, të akuzuarin e:

**G J Y K O N:**

**ME DËNIM ME BURGIM** në kohëzgjatje prej 4 (katër) muaj, i cili konform nenit 44 të KRRK-së, me pëlqimin dhe kërkesën e të akuzuarit zëvendësohet **ME DËNIM ME GJOBË** në shumën prej 500€ (pesëqind euro), të cilin dënim është i obliguar që ta paguajë në 3 (tre) kiste të barabarta dhe atë kistin e parë në shumën prej 170€ (njëqind e shtatëdhjetë euro), në muaj, ndërsa kistin e dytë dhe të tretë me nga 165€ (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë euro), për çdo në muaj, dhe atë në fillim të muajit prej 01-05 të muajit vijues, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse dënimi me gjobë nuk ekzekutohet në afatin ligjor i njëjti do të zëvendësohet me 25 (njëzet e pesë) ditë dënim burgu duke llogaritur për 20 € një ditë burg.

Detyrohet i akuzuari M.Ç., që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë për ekspertizën mjeko-ligjore shumën prej 50 (pesëdhjetë euro), ekspertizën e komunikacionit në shumën prej 40.88€ (dyzet euro e tetëdhjetë e tetë cent), shpenzimet e paushallit gjyqësorë në shumën prej 20€ (njëzet euro), ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 20€ (njëzet euro), të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të dëmtuarit M.Ç., S.Ç., A.Ç., dhe Sh.J., që të gjithë nga Prizreni, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

**A r s y e t i m**

*1. Ecuria e procedurës penale*

Prokuroria Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate përkatësisht në Departamentit të Përgjithshëm me datën 24.02.2021, ka ngritur aktakuzën me numër PP/II.nr.203-9/2021, të datës 24.02.2021, kundër të akuzuarit M.Ç., nga Prizreni, për shkak të veprës penale: rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par.8 lidhur me par. 6 dhe 1 të KPRK-së dhe së bashku me aktakuzë është dorëzuar edhe marrëveshja për pranimin e fajësisë me numër PP/II.nr.203-9/2021, të datës 25.02.2021, e lidhur në mes të Prokurorisë Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm në njërën anë, si dhe të akuzuarit M.Ç., dhe mbrojtësit të tij në anën tjetër. Sipas kësaj marrëveshje gjykatës i është rekomanduar që ndaj të akuzuarit për shkak të veprës penale: rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par.8 lidhur me par. 6 të KPRK-së, ti shqiptohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muaj me mundësi zëvendësimi me dënim me gjobë në shumën prej 500€ (pesëqind euro).

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë me datën 26.03.2024, në të cilën seancë është shqyrtuar marrëveshja për pranimin e fajësisë ku është dëgjuar i akuzuari M.Ç., Prokurori i shtetit Ramadan Koro, si dhe mbrojtësi i të akuzuarit av. A.A.,.

I akuzuari M.Ç., gjatë seancës për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë ka deklaruar se: marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë e ka nënshkruar personalisht pas konsultimeve mjaftueshme me mbrojtësin e tij, i kupton të gjitha pasojat e pranimin të fajësisë, e kupton faktin se me pranimin e fajësisë sipas marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë heqë dorë nga e drejta në gjykim të rregullt si dhe të gjitha të drejtat që kanë të bëjnë me një gjykim të rregullt, e kupton aktakuzën përkatësisht veprën penale, e cila i vihet në barrë me aktakuzë dhe e pranon fajësinë për veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par.8 lidhur me par. 6 dhe 1 të KPRK-së, dhe kërkon nga gjykata që të shqiptojë dënimin e rekomanduar nga marrëveshja e pranimin të fajësisë.

Prokurori i shtetit Ramadan Koro, gjatë seancës për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë ka deklaruar se: mbetet në tërësi pranë marrëveshjes të lidhur me shkrim të lidhur mes prokurorit të çështjes dhe të pandehurit me prezencën e mbrojtësit të tij dhe kërkon nga gjykata që të njëjtën ta aprovon si është e shkruar dhe me propozimet që kanë dal, ndërsa sa i përket dënimin gjykata ta aprovon si është propozuar në marrëveshje.

Mbrojtësi i të akuzuarit av. A.A., gjatë seancës për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë ka deklaruar se: e mbështesim në tërësi marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, e cila është bërë në mënyrë vullnetare nga i mbrojturi i tij. Konsideron se e njëjta është bindëse për gjykatën dhe i propozon që e njëjta të aprovohet. Në vazhdim ka shtuar se duke marr parasysh se i akuzuari ka edhe këste të kredisë, kërkon nga gjykata që shumën prej 500 euro t'ia mundëson që ta paguajë në tre këste, për këtë gjykatës ia prezentonë edhe provën, gjendjen e llogarisë bankare të akuzuarit me të cilën vërtetohet se i njëjti ka edhe këste të kredisë, andaj kërkon që të aprovohet një kërkesë e tillë dhe do të ishte një lehtësim tejet i madh për të akuzuarin.

I akuzuari M.Ç., gjatë seancës për caktimin e dënimin ka deklaruar se: pajtohet me fjalët e mbrojtësit të tij.

## 2. Vlerësimi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë

Në seancën publike për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë të mbajtur me datën 26.03.2024, pas shqyrtimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë të paraqitur nga Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti përgjithshëm, me numër PP/II.nr.203-9/2021, të datës 25.02.2021, e cila ka të bëjë me të akuzuarin M.Ç., për shkak të veprës penale: rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par.8 lidhur me par. 6 dhe 1 të KPRK-së, si dhe deklarimit për pranimin e fajësisë të bërë nga i akuzuari në pajtim me dispozitat e nenit 230 par. 17 të KPP-së, Gjykata ka gjetur se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë dhe pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë të vullnetshme pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij av. A.A., i akuzuari nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza. Gjithashtu gjykata ka konstatuar se në shkresat e lëndës ka prova të mjaftueshme që vërtetojnë faktin se i akuzuari ka kryer veprën penale me të cilën ngarkohet me aktakuzë dhe atë duke u bazuar në pranimin e fajësisë nga vet i akuzuari dhe marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë dhe si dhe në provat tjera të cilat i përmban aktakuza të cilat prova janë të mjaftueshme për të vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, ku gjithashtu gjykata ka konstatuar se në shkresat e lëndës nuk ekziston asnjë rrethanë e paraparë me nenin 258 par.1 dhe 2 të KPP-së për pushimin e procedurës përkatësisht hedhjen e aktakuzës, prandaj gjykata pas dëgjimit të palëve dhe të mbrojtësit të të akuzuarit, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar

marrëveshja mbi pranimin e fajësisë ka mbështetje ligjore dhe bazuar në nenin 230 par.20 të KPP-së të njëjtën e ka pranuar dhe ka vendosur në shkresat e lëndës.

### 3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

- se i akuzuari M.Ç., nga pakujdesia ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par.8 lidhur me par. 6 dhe 1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruara si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

### 4. Elementet e veprës penale

Në nenin 370 paragrafi 1 të KPRK, është parashikuar se formën themelore të veprës penale rrezikimi i trafikut publik e kryen: *“Kushdo që shkel ligjin mbi trafikun publik apo transportin rrugor dhe rrezikon jetën e njerëzve apo pasurinë dhe me këtë i shkakton dikujt dëm të konsiderueshëm pasuror”* Ndërsa, në paragrafin 6 të këtij neni, është parashikuar forma e lehtë e kësaj vepre penale, e cila konsiderohet se ekziston *“Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet nga pakujdesia”*. Ndërsa në paragrafin 8 të këtij neni është parashikuar pasoja me e rëndë e kësaj vepre penale *“Nëse vepra penale nga paragrafi 6. i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor ose dëm pasuror në vlerë prej njëzetmijë (20.000) Euro apo më shumë, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet”*.

### 5. Vendimet e gjyqtarit të vetëm gjykues

Duke u bazuar në këto që janë cekur më lartë, gjyqtari i vetëm gjykues të akuzuarin M.Ç., e ka shpallur fajtor për veprën penale për të cilën është ngarkuar ngase në veprimet e të akuzuarit të përshkruara në dispozitiv të aktgjyimit formohen të gjitha elementet e veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par.8 lidhur me par. 6 dhe 1 të KPRK-së, për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

### 6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit ka vlerësuar se duhet të aprovohet rekomandimi i paraqitur në marrëveshjen për pranimin e fajësisë që ndaj të akuzuarit M.Ç., të shqiptohet dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ngase ka vlerësuar se duke i marrë për bazë të gjitha rrethanat e shënuara më poshtë, të cilat duke i ndërlidhur njëra me tjetrën janë vlerësuar rrethana posaçërisht lehtësuese dhe se dënimi me burgim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi do të jetë dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale. Me rastin e matjes së dënimit ndaj të akuzuarit gjyqtari i vetëm gjykues i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, të parashikuara në nenet 69 dhe 70 të KPRK-së. Kështu, si rrethanë lehtësuese gjykata ka vlerësuar faktin se i akuzuari ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë me Prokurorinë Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, i akuzuari ka bashkëpunuar me prokurorin e shtetit; se pranimin e fajësisë e ka bërë gjatë të gjitha fazave të procedurës penale; se i akuzuari është penduar thellë për kryerjen e kësaj vepre penale, sjelljen korrekte gjatë shqyrtimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë, dhe rrethanat personale të akuzuarit: është mbajtës i familjes baba i 4 fëmijëve. Andaj, duke

pasur parasysh se i akuzuari e ka pranuar fajësinë sipas marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë si dhe duke mos gjetur rrethana rënduese, gjykata ka ardhur në përfundim se këto janë rrethana, që tregojnë me dënimin e shqiptuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi mund të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së dhe tek i akuzuari me të drejtë mund të pritët që në të ardhmen nuk do të kryejë ndonjë veprë tjetër penale dhe se dënimi i shqiptuara sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

### 7. Zëvendësimi i dënimit me burgim në dënim me gjobë

Gjyqtari i vetëm gjykues, duke u bazuar në nenin 44 të KPRK-së, me pëlqimin e të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, dënimin me burgim të shqiptuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi i ka zëvendësuar me dënim me gjobë në shumën që është shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, i cili dënim do të paguhet në tre kiste mujore, duke i marr për bazë rrethanat e lartcekura të cilat vërtetohen nga llogaria bankare e tij del se i njëjti është në kredi, andaj pagesa e menjëhershme e dënimit me gjobë do ti shkaktonte vështirësi ekonomike në mbajtjen e familjes së tij.

### 8. Vendimi lidhur me kërkesën pasurore juridike

Gjykata, duke u bazuar në nenin 462 paragrafi 2 të KPP, ka vendosur që të dëmtuarit, për realizimin e kërkesës pasurore juridike ti udhëzojë në kontest të rregullt juridiko civil, ngase, të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtë, të kërkesës pasurore juridike.

### 9. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 449 par.1 dhe 2 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPP-së, ndërsa për shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 36 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, komfor nenit 364 të KPP-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal**  
**P.nr.230/2021 më datë 26.03.2024**

**Zyrtari Ligjor**  
**gjykues**  
**Amar Hoxha**

**Gjyqtari i vetëm**  
**Arlind Sharani**

**UDHËZIMI JURIDIK:** Ndaj këtij aktgjykimi palët nuk kanë të drejtën e ankesës për shkak të vendimit mbi dënimin dhe për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes

Numri i lëndës: 2021:027624  
Datë: 26.03.2024  
Numri i dokumentit: 05507891

faktike. Ankesa për bazat e tjera mund të ushtrohet në afat prej 30 ditëve, prej ditës së marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes Gjykatës Themelore në Prizren.